



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 149/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.04.2020, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e shoqërisë “El-Gjo-2006” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr. REF-51542-02-05-2020, me objekt: “*Blerje ushqime për fëmijë*”, me fond limit 4.166.666 lekë pa tvsh, zhvilluar me date 17.03.2020, nga autoriteti kontraktor, Shtëpia e Fëmijëve 6-14 vjec Shkodër.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e shoqërisë “Shkambia-A” sh.p.k në procedurën e prokurimit.

Ankimues: “El-Gjo-2006” sh.p.k
Rruga “Ing.Gjovalin Gjadri”, Nr. Pasurisë 14/202, Shkodër

Autoriteti Kontraktor: Shtëpia e Fëmijëve 6-14 vjec Shkodër.
L. “Naim Gjylbegu”, Blv. “Bujar Bishanaku”, Shkodër

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27.02.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr. REF-51542-02-05-2020, me objekt: “Blerje ushqime për fëmijë”, me fond limit 4.166.666 lekë pa tvsh, zhvilluar me date 17.03.2020, nga autoriteti kontraktor, Shtëpia e Fëmijëve 6-14 vjec Shkodër.

II.2. Në datën 24.03.2020 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar. Nga vlerësimi i bërë nga KVO-ja rezulton si më poshtë:

- | | |
|------------------------|------------------------------|
| 1. “Nika” sh.p.k | 3.809.090 lekë, skualifikuar |
| 2. “El-Gjo-2006”sh.p.k | 3.958.250 lekë, skualifikuar |
| 3. “Shkambi-A” sh.p.k | 4.118.000 lekë, kualifikuar |

Operatori ekonomik “El-Gjo-2006”sh.p.k është njoftuar nga KVO për arsyet e skualifikuar si më poshtë:

-Nuk keni paraqitur xhiron e vitit 2016 sipas kerkesave te percaktuara ne DST, pika 1, kapaciteti ekonomik dhe financiar ku specifikohet qe : "Operatori ekonomik ofertues duhet te kete kryer xhiro mesatare vjetore per vitet 2016,2017 dhe 2018 ne nje vlere prej 4 166 666 (Katermilion e njeqind e gjashtedhete e gjashtemije e gjashteqind e gjashtedhete e gjashte) leke.

Nga te dhenat e rregjistrimit tregtar te shoqerise tuaj rezulton se shoqeria eshte rregjistruar ne vitin 1996 dhe se ne vitin 2016 ju keni ushtruar aktivitet tregtar dhe nuk keni qene te pezulluar si aktivitet ekonomik nga organet perkatese.

Nese marrim parasysh edhe xhiron e realizuar nga subjekti juaj ne vitin 2016 sipas pasqyrave te bilancit te vitit 2016, rezulton se ju nuk plotesoni kushtin e xhiros mesatare vjetore prej 4 166 666 (Katermilion e njeqind e gjashtedhete e gjashtemije e gjashteqind e gjashtedhete e gjashte) leke

-Nga verifikimi i vlefshmerise se certifikates tuaj H.A.C.C.P ne faqen e shoqerise e cila ka leshuar kete certifikate rezulton se nuk figuron e publikuar ne sistemin e tyre.

-Mostrat e djathit, filetose se pules, dhe mishit te pules nuk jane sipas sipas specifikimeve teknike te kerkuara ne DST, pasi ato jane sjelle pa etikete, nuk dihet origjina, prodhuesi, date skadence etj.

II.3. Në datën 27.03.2020, operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke pretenduar si vijon:

" [...]

Ne lidhje me argumentin e pare te skualifikimit sqarojme.

1-Ne kemi paraqitur xhiron e tre viteve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit ashtu sic percaktohen ne ligjit m. 9643, date 20.11.2006 "Per prokuriminpublik" dhe VKM nr.914, date 29.12.2014, "Per Rregullat per Prokurimin Publik" (i ndryshuar) dhe ne e tejkalojme kete xhiro me kerkesat qe keni ju ne dst.

Per kete kerkese kemi dorezuar ne sistemin APP vertetimin e xhiro ku jane: (viti 2017=0 leke + viti 2018 = 6120920 leke +viti 2019 = 13585609 leke) = gjithsej 19706529 /3 vite = 6 558 843 lek mesatarje e tre viteve te fundit

Si ka mundesi qe ju ne shtojcen e publikuar nga ana juaj kerkoni qe operatori ekonomik te kete furnizime te ngjashme ne nje vlere prej 1166 666 leke, te ekzekutuar gjate tre viteve te fundit NDERSA xhiron e kerkoni JO GJATE tre viteve te fundit!!!!!!!!!!!!. [...].

Nje tregues shume i mire jane kontratat e ngjashme te realizuara gjate 3 viteve te fundit.

Argumenti i pare i skualifikimit nuk qendron, pasi xhiroja e tre viteve te fundit e plotesojme.

Ne lidhje me argumentin e dyte te skualifikimit sqarojme

Per verifikimin e vlefshmerise se certifikates tuaj HA.C.C.P ne faqen e shoqerise e cila e ka leshuar kete certifikate rezulton e cila nuk figuron e publikuar ne sistemin e tyre.

Kjo certifikate eshte ne faqen e e shoqerise e cila e ka leshuar kete certifikate dhe kontrollat qe kemi bere ne, rezulton se figuron e publikuar ne sistemin e tyre, qe me date 02.03.2020. Nuk e dimi se ku, dhe ne cilen faqe keni kontrolluar ju, ose nuk keni kontrolluar ne faqen e duhur, ose e nxirrni kot si argument skualifikues. (bashklidhur dokumentet shoqeruese). Pse nuk kontaktuat me shoqerin qe e ka leshuar kete certifikate, po pse nuk respektuat nenin 53 te ligjit i cili thote: KVO kur e shikon te arsyeshme, u kerkon ofertuesve sqarime per ofertat e tyre.

Ne lidhje me argumentin e trete te skualifikimit sqarojme:

Mostrat e djathit, fileto pule, dhe mishit te pules jane dorezuar sipas specifikimeve teknike te kerkuara ne dst, pasi ato jane sjelle me etikete, ne te cilen eshte shenuar qarte origjina, prodhuesi, data e skadences si dhe keto mostra jane te shoqeruar dhe me flete analiza perkatese ne te cilen jane pasqyruar po keto tregues.

Pranimi i mostrave nga ana e AK ka qene ne kundershtrim te plote me udhezimin nr 2 date 02.05.2018 te APP "Mbi procesin e administrimit te mostrave te paraqitura nga operatoret ekonomike", pasi nuk eshte zbatuar asnje pike te ketij udhezimi

Ne udhezimin nr 2 date 02.05.2018 te APP "Mbi procesin e administrimit te mostrave te paraqitura nga operatoret ekonomike ", thuhet pika 2- Faza e paraqitjes se mostrave i sherben autoritetit kontraktor per te gjykuar me mire mbi permbushjen e specifikimeve teknike te kerkuara per objektet qe prokurohet, me qellim qe cilesia e mallit te jete ne perputhje me kerkesat e percaktuara prej tij.

Ne kete kuptim, ne rastin kur autoriteti kontraktor vlereson si te nevojshem dorezimin e mostrave, ne daten dhe oren e percaktuar ne dokumentat e tenderit per paraqiten e tyre nga ofertuesit, duhet te mbahet nje procesverbal, i cili dokumenton procesin e paraqitjes se mostrave, PRA E THEKSOJME i cili dokumenton procesin e paraqitjes se mostrave

Nje kopje e ketij procesverbali te mbajtur me ofertuesin/ofertuesit e pranishem duhet t'i vihet ne dispozicion ketij/ketyre tef undit.

Procesverbali i paraqitjes se mostrave te mallit, i cili administrohet ne dosjen e tenderit, duhet te pasqyroje cdo hap te ndjekur nga komisioni i vleresimit te ofertave ose anetaret e komisionit te prokurimit me vlere te vogel, ne lidhje me administrimin e tyre.

Pranimi i mostrave nga ana e AK ka qene ne kundershtrim te plote me kete udhezimin, na jane marre mostrat tek dera e institucionit dhe na eshte dhene nje cope leter, duke na thene dhe OK. Nuk po e kuptojme se cfare proces verbal i administrimit te mostrave eshte kjo leter zehle ku ne te thuhet ... Se sot me date 17.03.2020 u be dorezimi i dokumentacionit dhe mostrave nga firma "EL-GJO-2006" per tenderin e ushqimeve.... dhe pa asnje komision te pranishem.

Ku jane ne proces verbal, hapat te ndjekur nga komisioni i vleresimit, ne lidhje me administrimin e tyre.

Argumentat e skualifikimit nuk qendrojne.

[...].Nga komisioni i vleresimit te ofertave na ka skualifikuar ne si operator ekonomik pa asnje arsye te ligjshme, duke shkelur hapur kriteret e vleresimit te percaktuara ne dokumentat e tenderit, Ligjin nr. 9643, date 20.11.2006, "Per Prokurimin Publik", (i ndryshuar) e VKM nr.914, date 29.12.2014, " Per Rregullat per Prokurimin Publik" (i ndryshuar).

Shoqerite tona eshte trajtuar ne menyre diskriminuese nga KVO-ja duke na skualifikuar qellimishte ne dhe shpall fitues operatorin ekonomik i cili eshte me vlere me te madhe se ne.

Te gjitha dokumentacionin e kerkuar sipas dst eshte dorezuar ne rregull, por KVO - ja nuk ka zbatuar drejte kerkesat e ligjit per vleresimin e kesaj procedure.

Ne kemi pretendimet tona dhe ne lidhje me dokumentacionin e dorezuar nga ana e operatorit te cilin ju e keni shpallur fitues, pasi nga informacionet konfidenciale qe kemi konstatojme se ka shume mangesi ne dokumentacionin e dorezuar nga ana e tij dhe ju prape e keni shpallur fitues. Ndaj kerkojme edhe njehere rishqyrtimin me themel te dokumentacionit dhe te ketij operatori ose kjo do ti ngelet per investigim organeve te tjera ligjzbatuese.

II.4. NËpërmjet shkresës nr.37 prot., datë 01.04.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit duke e refuzuar ankesën si vijon:

“ [...]

I-Ne lidhje me arsyen e pare te skualifikimit te bere nga KVO.

Bazuar ne DST e publikuara nga AK, kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 1, eshte shprehur si me poshte:

Operatori ekonomik ofertues duhet te kete kryer xhiro mesatare vjetore per vitet 2016, 2017 dhe 2018 ne nje vlere prej 4 166 666 (Katermilion e njeqind e gjashtedhete e gjashtemije e gjashteqind e gjashtedhete e gjashte) leke. Ne plotesimin e kesaj pike operatori ekonomik duhet te paraqese: a)Vertetim nga Dega e Tatim-Taksave per xhiron e realizuar gjate ketyre viteve. Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistemin e APP ne permbushje te ketij kriteri qe eshte dhe objekt ankimesi, rezulton se ju keni paraqitur vertetim (Per Xhiron e Tre Viteve Te Fundit) Nr. T01908205 Date, 06.03.2020. Ky dokument eshte gjeneruar dhe vulosur me ane te nje procedure automatike nga nje sistem elektronik (Drejtoria Rajonale Tatimore Shkoder).

Bazuar ne dokumentin e mesiperme rezulton se ju keni paraqitur xhiron per vitet 2017-2018-2019, por mungon xhiroja e vitit 2016 sic kerkohet ne kriterin e sipercituar me lart, duke mos e plotesuar kete kriter me ane te dokumentacionit te mesiperme.

Pretendimet tuaja se ju keni paraqitur xhiron e tre viteve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit, pasi ashtu eshte percaktuar ne ligjin nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar dhe VKM nr.914, dt.29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", e ndryshuar, pasi edhe furnizimet e ngjashme ne DST kerkohen qe te jene te tre viteve te fundit nuk qendrojne, pasi ne ligjin nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar, neni 46, pika c, "kualifikimi i ofertuesve", nder te tjera kerkohet si me poshte:

c) gjendja ekonomike e financiare: operatoret ekonomike vertetojne se zoterojne kapacitetet ekonomike e financiare per te permbushur kontraten, me ane te deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nepermjet vertetimit per sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes se bilanceve financiare ose te pjeseve te shkeputura nga bilancet, nje deklarate te xhiros se pergjithshme te shoqerise dhe, ne rast nevojje, te xhiros se realizuar nga veprimtarite e ngjashme me objektin e kontrates qe do te prokurohet per nje periudhe deri ne 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion eshte i mundur.

Pra ne kundërshtim me argumentet tuaja, ligji shprehet se xhiroja dhe bilancet paraqiten per nje periudhe deri ne 3 vitet e fundit financiare dhe jo tre vite nga data e zhvillimit te tenderit dhe gjithmone kur ky informacion eshte i mundur.

Ne lidhje me kete te fundit, kur ky informacion eshte i mundur sqarojme se bazuar ne Ligjin nr. 8438, date 28.12.1998, "Per Tatimin mbi te Ardhurat", i ndryshuar, neni 29, "Deklarimi tatimor dhe llogaritja perfundimtare e detyrimit", shprehet si me poshte:

Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes, duke paraqitur ne te njejten kohe bilancin kontabel, se bashku me anekset e tij, si dhe cdo te dhene tjeter te percaktuar ne udhezimin e Ministrimit te Financave ne zbatim te ketij ligji..." Duke u nisur nga percaktimet e mesiperme Autoriteti Kontraktor, bazuar ne ligjin nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 2 ku shprehet "Perzgjedhja e fituesve te kontratave publike realizohet ne perputhje me keto parime te pergjithshme:

- a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabarte i ofertuesve ose kandidateve;
- b) transparence ne procedurat e prokurimit;
- c) barazi ne trajtimin e kerkesave dhe te detyrimeve, qe u ngarkohen ofertuesve ose kandidateve.

ka percaktuar qe ofertuesit duhet te paraqesin deklaraten e xhiros vjetore 2016-2017-2018 duke patur parasysht qe per vitin 2019 afati eshte deri me 31.03.2020 dhe deklarata vjetore lidhet bashke me depozitimin e bilancit, duke vendosur ne kushte te barabarta te gjithe ofertuesit.

Per me teper nga monitorimet e APP te procedurave te prokurimit te fillim vitit, eshte udhezuar qe xhiroja e vitit te fundit financiar te kerkohet vetem per ato procedura prokurimi qe kane si date te hapjes se ofertave muajin prill, duke i dhene mundesine operatoreve ekonomik qe te jene ne kushte te barabarta. Gjithashtu kjo procedure prokurimi eshte monitoruar nga APP pasi, ne zbatim te rekomandimeve te saj, eshte hartuar nje shtojce per ndryshim kriteresh dhe nga ky monitorin eshte vleresuar se kerkesa per xhiron vjetore eshte e sakte pasi data e hapjes se ofertave ka qene 17.03.2020.

Nga te dhenat e rregjistrimit tregtar te shoqerise tuaj rezulton se shoqeria eshte rregjistruar ne vitin 1996 dhe se ne vitin 2016 ju keni ushtruar aktivitet tregtar dhe nuk keni qene te pezulluar si aktivitet ekonomik nga organet perkatese prandaj i keni patur te gjitha mundesite qe te paraqitnit ne tender xhiron e vitit 2016.

Nese marrim parasysht edhe xhiron e realizuar nga subjekti juaj ne vitin 2016 sipas pasqyrave te bilancit te vitit 2016, rezulton se ju nuk plotesoni kushtin e xhiros mesatare vjetore prej 4166666 (Katermilion e njeqind e gjashtedhjetë e gjashternije e gjashteqind e gjashtedhjetë e gjashtë) leke per tre vitet e kerkuara 2016-2017-2018.

Nese ju si operator ekonomik ankimes do te kishit pretendime ne lidhje me kerkesen e mesiperme te autoritetit kontraktor, keni patur ne dispozicion momentin procedural te paraqitjes se ankeses mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve te vecanta te kualifikimit te procedurës se prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Ne nenin 63 pika 1/1 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se "Ne rastin e ankesave per dokumentet e tenderit, operatoret ekonomike mund te ankohen prone autoritetit kontraktor brenda 7 diteve nga data e publikimit te njoftimit te kontrates ne faqen ne internet te Agjencise se Prokurimit Publik. Me marrjen e ankeses me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës se prokurimit, derisa ankesa te jete shqyrtuar plotesisht, perfshire dhe nxjerrjen e nje vendimi brenda 3 diteve nga data e depozitimit te ankeses. Ndaj vendimit perfundimtar te autoritetit kontraktor mund te behet ankim ne Komisionin e Prokurimit Publik, ne perputhje me piken 6 e ne vijim te ketij neni". Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon nje sere elementesh si garanci per operatoret ekonomike te cilet kane paqartesi ne lidhje me interpretimin e kerkesave te autoritetit kontraktor dhe/ose menyres se plotesimit te kriterëve kualifikuese. Ne rast se ju si operator ekonomik ankimes do te kishit paqartesi ne lidhje mbi plotesimin e kerkeses se mesiperme, keni ne dispozicion momentin procedural te paraqitjes se kerkeses per sqarime prane autoritetit kontraktor deri ne pese dite para dorezimit te ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-se. Ne nenin 42, pika 1 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se "[...] Ofertuesi i mundshem mund te kerkoje sqarime per dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i pergjigjet cdo kerkesë per sqarim

te dokumenteve te tenderit, te bere nga cdo operator ekonomik, me kusht qe kerkesa te jete marre jo me vone se 5 dite para afatit perfundimtar te dorezimit te ofertave. Autoriteti kontraktor duhet te pergjigjet brenda 3 diteve nga depozitimi i kerkeses, ne menyre qe te beje te mundur dorezimin e ofertes ne kohe nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kerkeses, duhet t'ia komunikojte sqarimin perkates te gjithe operatoreve ekonomike, qe kane terhequr dokumentet e tenderit [...].

Ne lidhje me kete pike arsytet e skualifikimit te bera nga KVO qendrojne dhe pretendimet tuaja nuk merren parasysh.

-Ne lidhje me arsyen e dyte te skualifikimit te bere nga KVO

2. Ju jeni skualifikuar nga KVO me kete pretendim:

-Nga verifikimi i vlefshmerise se certifikates tuaj H.A.C.C.P ne faqen e shoqerise e cila ka leshuar kete certifikate rezulton se nuk figuron e publikuar ne sistemin e tyre.

Ne formularin e ankeses drejtuar Autoritetit Kontraktor ju pretendoni se kjo certifikate rezulton e publikuar ne faqen e shoqerise e cila e ka te publikuar qe me date 02.03.2020

Bazuar ne Rekomandimin e Agjencise se Prokurimeve Publike dhe Agjencise se Pergjithshme te Akreditimit "Mbi hartimin e kerkesave te cilesise" pika 4, ku thuhet "Te gjitha certifikatat e cilesise qe vleresohen te nevojshme nga autoriteti kontraktor duhet te jene leshuar nga organe te konformitetit te cilet jane te akredituara nga DPA", nga verifikimi ne ne faqen zyrtare te DPA rezulton se shoqeria ACScert sh.p.k nuk eshte e akredituar nga DPA per leshimin e certifikates H.A.C.C.P.

Ne lidhje me kete pike arsytet e skualifikimit te bera nga KVO qendrojne dhe pretendimet tuaja nuk merren parasysh.

Ne lidhje me arsyen e trete te skualifikimit te bere nga KVO

3. Ju jeni skualifikuar nga KVO me kete pretendim:

-Mostrat e djathit, filetos se pules, dhe mishit te pules nuk jane sipas sipas specifikimeve teknike te kerkuara ne DST, pasi ato jane sjelle pa etikete, nuk dihet origjina, prodhuesi, date skadence etj.

Ne formularin e ankeses drejtuar Autoritetit Kontraktor, ju pretendoni se marrja e mostrave eshte bere ne kundershtim me udhezimin e APP nr.2 date 02.05.2018.

Bazuar ne DST e publikuara nga AK, kapaciteti teknik, pika 10 eshte shprehur si me poshte: Diten e hapjes se tenderit operatoret ekonomik ofertues te bejne paraqitjen e mostrave per artikujt me nr. rendor 6, 13, 18, 32, 45, 53, 54. Mosparaqitja e mostrave ose mosperputhja me specifikimet teknike perben kusht per skualifikim

Diten e hapjes se tenderit ju si ofertues keni paraqitur mostrat e kerkuara sipas kerkeses se AK, por arsyeja juaj e skualifikimit eshte se keto mostra nuk jane sipas specifikimeve teknike te kerkuara, jane pa etikete dhe pa date skadence. Kundershtimet tuaja jane se ato nuk jane marre me procesverbal nga ana e AK, por ju si ankimues nuk kundershtoni aspak faktin se mostrat e paraqitura nuk jane si specifikimet teknike te kerkuara. Nga ana e AK jane fotografuar dhe dokumentuar te gjitha mostrat e paraqitura nga ofertuesit ditene tenderit.

Ne lidhje me kete pike arsytet e skualifikimit te bera nga KVO qendrojne dhe pretendimet tuaja nuk merren parasysh.

Ne perfundim te shqyrtimit te ankeses bazuar ne nemn 46, pika 1 e ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht: "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohen dhe jodiskriminuese", ne nenin 53/3 te LPP-se ku parashikohet se: "Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentat e tenderit... ", ne dokumentat standarde te tenderit "Udhezime per operatoret ekonomike" percaktohet: "Operatoret Ekonomike jane te detyruar te pergatisin oferta, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne keto DT. Ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto DT do te refuzohen si te papranueshme", vleresojme se ankesa e bere nga shoqeria EL-GJO-2006 sh.p.k nuk eshte e drejte dhe se pretendimet tuaja nuk qendrojne. Pretendimet e shoqerise EL-GJO-2006 sh.p.k nuk merren parasysh. Ankesa e bere ju refuzohet."

II.5. Në datën 08.04.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.6. Në datën 15.04.2020 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 338/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 38 prot., datë 14.04.2020, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues "El-Gjo-2006" sh.p.k se: "[...]Mostra e djathit, nuk është sipas sipas specifikimeve teknike te kerkuara ne DST, pasi ajo është sjelle pa etikete, nuk dihet origjina, prodhuesi, date skadence etj", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8, « Kriteret e vecanta të kualifikimit », « Kapaciteti teknik », pika 10, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

Diten e hapjes se tenderit operatoret ekonomik ofertues te bejne paraqitjen e mostrave per artikujt me nr.rendor 6,13,18,32,45,53,54,. Mosparaqitja e mostrave ose mosperputhja me specifikimet teknike perben kusht per skualifikim

III.1.2. Në shtojcën 9 "Specifikimet teknike", lidhur me artikullin "Djath i bardhë", është parashikuar:

DJATH I BARDHE

Bazuar ne STASH.....1410\87

Lloji: Djath feta i cilesise se pare

- Ngjyra: E bardhe
- Forma: prizem, trekendesh me nje siperfaqe anesore cilindrike.
- Masa e formes ne g, 2-3 kg
- Era dhe shija: E kendshme, specifike e djathit te bute te stazhionuar ,pa shije te hidhur dhe djegese, pa shije dhe ere te huaj.
- Pamja e jashtme dhe e brendshme: e formuar mire, e paster dhe pa njolla.
- Lejohen plasaritje te lehta ne siperfaqe.
- Ne prerje eshte e njellojte e paster pa lende te huaja me sythe teknike ,me ngjyre te bardhe deri ne krem.
- Struktura dhe konsistenca; e lemuar jo e forte dhe pa dallim shtresash.

Treguesit fiziko-kimike:

1-Lageshtira ne %, jo me shume se

Per periudhen 1.05-30.09,52

Per periudhen 1.10-30.4,56

2-Lendet e thata ne %,jo me pak se

Per periudhen 1.05-30.09,48

Per periudhen 1.10-30.04,44

3- Yndyra ne lendet e thata ne %,jo me pak se 50

4-Kripe ne % deri 4+-1

5-Ngarkesa mikraobike Brenda normave te lejuara nga Ministria e Shendetise.

Ambllazhimi: Ne voza plastike me vellim 50 l. Djathi ne voze qendron i mbuluar me shelliren fillestare e cila permban 0-14 % kripe deti.

Mbi cdo ambllazh me djathe vendoset etiketa ne te cilen shenohen :

- Emertimi i prodhuesit
- Emri produktit
- Pesh neto ose vellimi i produktit
- Data e prodhimit
- Kushtet e vecanta te ruajtjes
- Rekomandime per perdorim, nese keto ndikojne ne menyre te ndjeshme mbi afatet e ruajtjes se cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë. këto të dhëna të jepen mbi ambllazh ose mbi etiketë.

Ambalazhimi: Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet ne menyre qe te mos shkepulet nga ambalazhi.

Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jene të qarta, të dukshme mire, të pashlyeshme dhe lehtesisht të lexueshme ne kushtet normale të blerjes dhe perdorimit.

N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jete lehtesisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.

Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy qe në pamje të parë.

N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret nje etikete shtese që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.

Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me nje tjetër shenimet e detyrueshme duhet të jene pikë për pikë si të etiketës orgjinale.

Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit.

Ruajtja dhe transportimi: Djathrat e bute ruhen ne frigorifer ne temperature 3- 5°C,dhe lageshti relative te ajrit rreth 95%. Koha e ruajtjes ne keto kushte eshte deri ne 12 muaj.

Transportimi i djathrave te bute nga nje rreth ne tjetrin behet me mjete frigoriferike. Ndersa brenda rrethit lejohet transportimi i tyre me mjete te zakonshme te mbuluara e te pastra te cilat jane te destinuara per transportimin e prodhimeve ushqimore.

Sipas shtojcws 11 « Sasia dhe grafiku i luvrimit », tw dokumentave tw tenderit, artikulli me numwr rendor 13 wshtw « djath i bardhw » si mw poshtw:

<i>Nr</i>	<i>Emertimi</i>	<i>Njesia</i>	<i>Sasia</i>
13	Djath i bardhe	kg	550

III.1.3. Operatori ekonomik ankimues “El-Gjo-2006” sh.p.k argumenton se: “*Mostrat e djathit, fileto pule, dhe mishit te pules jane dorezuar sipas specifikimeve teknike te kerkuara ne dst, pasi ato jane sjelle me etikete, ne te cilen eshte shenuar qarte origjina, prodhuesi, data e skadences si dhe keto mostra jane te shoqeruar dhe me flete analiza perkatese ne te cilen jane pasqyruar po keto tregues.*”

III.1.4. Në nenin 23, pika 4, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se: “4. *Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t’u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshatshme për mjedisin.* “

III.1.5. Në nenin 46, pika 1/b e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe*

besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës[...]”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

III.1.6. Në nenin 27 “Kontratat e mallrave”, pika 3, e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”. Ndërsa në pikën 6, po këtu, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*
- b) *dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike;dhe/ose*
- c) *dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”*

III.1.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.1.8. Referuar pretendimeve të ankimesit, argumentave të sjella nga autoriteti kontraktor si dhe nga shqyrtimi i mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik ankimes “El-Gjo-2006” sh.p.k, KPP konstatoi se për artikullin “Djath i bardhë” është dorëzuar mostër djathi, por mbi amballazhin

e saj nuk rezulton asnjë etiketë ku të jepen përshkrimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor si emërtimi i prodhuesit, data e prodhimit, pesha neto etj. Në këto kushte KPP gjykon se me të drejtë autoriteti kontraktor e ka konsideruar jo të rregullt mostrën e paraqitur nga ankimuesi pasi ajo nuk plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor për etiketën që do të shoqërojë mallin me të dhënat përkatëse, sipas specifikimeve teknike.

Mostra, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të siguruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Në rastin konkret mostra e paraqitur nga ankimuesi “El-Gjo-2006” sh.p.k për artikullin “*Djath i bardhë*”, nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe është e pamundur të vërtetohet lidhja ndërmjet produktit të ofruar në ofertë, për të cilin është paraqitur edhe dokumentacioni përkatës, me produktin e paraqitur si mostër, për shkak të mungesës të etiketës, apo cdo shenje tjetër identifikuese të prodhuesit. Komisioni thekson se kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës dhe rrjedhimisht ky i fundit do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.1.9. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se *komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, si dhe bazuar në nenin 1 dhe nenin 2 të LPP në të cilët përcaktohet përkatësisht: “Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”;*

“Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:

a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;

b) transparencë në procedurat e prokurimit;

c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”;

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “El-Gjo-2006” sh.p.k nuk plotëson kriterin e vecantë të kualifikimit, lidhur me paraqitjen e mostrës së produktit “*djath i bardhë*”, në përputhje me specifikimet teknike.

Në rast se operatori ekonomik ankimues “El-Gjo-2006” sh.p.k do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar parashikohet se “*Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht,*

përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “El-Gjo-2006” sh.p.k për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron, operatori ekonomik “El-Gjo-2006” sh.p.k nuk përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P do të vazhdojë të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “El-Gjo-2006” sh.p.k për ofertuesin e kualifikuar nga KVO-ja dhe për zhvillimin e procedurës së prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se:

III.3.1.Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), parashikon se: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”

III.3.2.Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të argumentojë se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP nuk mund të pranohet. Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që operatori ekonomik ankimues, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në

ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesmarrës në procedurën e prokurimit, apo lidhur me zhvillimin e procedurës së prokurimit do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm i drejtpërdrejtë nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Për këtë arsye, këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “El-Gjo-2006” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr. REF-51542-02-05-2020, me objekt: “Blerje ushqime për fëmijë”, me fond limit 4.166.666 lekë pa tvsh, zhvilluar me date 17.03.2020, nga autoriteti kontraktor, Shtëpia e Fëmijëve 6-14 vjec Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 338 Protokolli

Datë 08.04.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha